REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL
QENDRA SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE DEVOLL

Nr. Prot. **Bilisht më, . .2026**

PROJEKT-VENDIM

NR. 23, DATË 20 / 02 /2026

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË PËRFITUESVE NË QENDRËN SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE TË BASHKISË DEVOLL VITI 2026

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenin 36 të Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", I ndyshuar, Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", I ndryshuar, ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojten e Fëmijëve", Ligji Nr. 86/2017 "Për financat e vetëqeverjes vendore", I ndryshuar, Ligji Nr.64/2025 "Për barazinë gjinore", Ligji nr. 11/2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje". Ligji Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, VKM-së Nr. 224 datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimet të kujdesit shoqëror". Ligjin Nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar Vendimin nr.823, date 06.12.2006 "Per Standartet e Sherbimeve te Perkujdesit Shoqeror, per te Moshuarit ne Qendrat Ditore. VKM nr. 518/2018 për kriteret dhe procedurat e shërbimeve komunitare dhe rezidenciale për persona në nevojë. VKM nr. 425, datë 27.06.2019, për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.Udhezimit Nr.911, date 27.12.2018 ''Per miratimin e standarteve te sherbimeve te kujdesit shoqeror ne qendrat komunitare shumedisiplinore'' per te ofruar nje sherbim sa me cilesor per gruper vulnerable qe marin sherbim ne qender.

PROPOZOJ:

1. Miratimin e **kritereve të pranimit të përfituesve në Qendrën Shumefunskionale Komunitare të Bashkisë Devoll**, sipas **Shtojcës nr. 1**, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Qendra Shumefunksionale Komunitare ofron shërbime sociale, edukative dhe mbështetëse për kategori në nevojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Përzgjedhja dhe pranimi i përfituesve kryhet mbi bazën e vlerësimit social nga strukturat përgjegjëse të Qendres Shumefunksionale Komunitare Bashkia Devoll.

4. Ngarkohet Drejtoria e Sherbimit Social dhe strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit te tij !

Konceptoi: Përgj. Qendres multfunksionale komunitare Devoll
Sofika Papa
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani
Konfirmoi bazën ligjore: Përgj. i sektorit Juridik dhe i prokurimeve
Eriksela Avdo
Konfirmoi: Sekretar i Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISË
Eduard Duro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

SHTOJCA NR. 1

KRITERET E PRANIMIT TË PËRFITUESVE

NË QENDRËN SHUMEFUNSKIONALE KOMUNITARE DEVOLL

I. Qëllimi i shërbimit

Qendra Multifunksionale Komunitare ka për qëllim ofrimin e shërbimeve sociale parandaluese, mbështetëse dhe integruese për individë dhe familje në nevojë, duke nxitur përfshirjen sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

II. Kriteret e përgjithshme të pranimit/ Kategoritë përfituese

Përfituesit duhet të:

1. Jenë **banorë të Bashkisë Devoll** ose të ndodhen përkohësisht në territorin e saj për arsye emergjente;
2. Të jenë në situatë nevoje sociale, të vërtetuar nga vlerësimi social;
3. Të mos përfitojnë të njëjtin shërbim nga institucione të tjera publike për të njëjtin qëllim;
4. Të respektojnë rregulloren e funksionimit të qendrës.
5. Familjet të cilat kanë aplikuar në sistemin elektronik të Ndihmës Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi online i pikëzimit për arsye të ndryshme.
6. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar dhe per te perfituar sherbimet ne qender , duhet të jenë verifikuar paraprakisht duke ju bërë vlerësimi i gjëndjes social-ekonomike nga punonjesit e qendres apo te komunikohet me sektoret e tjere te Drejtorise se Sherbimit Social mbi situaten e familjes/individit.
7. Familjet duhet të jenë familje në nevojë, në kushte të vështira social-ekonomike,pa të ardhura ose me të ardhura të pakta.
8. Familjet me k/familjarë të ve apo të divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
9. Familjet me të moshuar përfitues të një pensioni pleqërie që kanë probleme shëndetësore dhe të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet bazë.
10. Fëmijët të cilët ndjekën arsimin e mesëm ose të lartë dhe janë të vetëm në certificate për shkak të problemeve sociale familjare apo raste fatkeqësie kur të dy prindërit kanë ndëruar jetë.
11. Familjet në varfëri ekstreme dhe raste fatkeqësie që nuk i përballojnë dot shpenzimet, në bazë të të ardhurave të deklaruara dhe që janë përfituese nga sistemi elektronik e NE.

12. Familjet rome të cilat kanë problem me transferimin, regjistrimin apo vështirësi punësimi,etj.
13. Familjet të cilat kanë në përbërje të tyre dy anëtarë në çertifikatë të cilët kanë kaluar moshën aktive për punë dhe nuk kanë plotësuar moshën e pensionit për tu trajtuar me pagesë.
14. Familjet në nevojë që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuar apo invalidë pune.
15. Te gjitha rastet e referuara me Vendim nga Komisioni Biopsiosocial.
16. Individë në situata emergjente, që kanë nevojë për strehim dhe mbështetje afatshkurtër deri në 72 orë;
17. Të moshuar, që përfitojnë shërbime komunitare ditore (socializim, aktivitete rekreative, pije të ngrohta);
18. Gra dhe vajza në nevojë, përfshirë viktima të dhunës, diskriminimit apo përjashtimit social;
19. Persona me aftësi të kufizuara (PAK);
20. Per femjet qe do te marin sherbimin e terapise se zhvillimit mosha e percaktuar eshte nga 3-16 vjeç.
21. Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike

III.Shërbimet që ofrohen ne Qender.

- Shërbime ditore për PAK
- Shërbime ditore per të moshuarit;
- Mbështetje edukative për fëmijë (detyrat pas shkollës);
- Mbështetje psiko-sociale për gra,burra, te rinj dhe fëmijë;
- Shërbim emergjence deri në 72 orë;
- Aktivitete komunitare dhe integruese për komunitetet rom dhe egjiptian dhe famljet apo personat ne nevoje;
- Aktivitete rekreative dhe socializuese.

IV. Procedura e pranimit

1. Paraqitja e kërkesës nga individi/familja ose referimi nga institucionet;
2. Vlerësimi nga **punonjësi social dhe grupi multidisiplinar** me ane te nje formulari vleresimi.
3. Vendimi për pranimin merret nga struktura përgjegjëse te Qendres Shumefunksionale Komunitare Devoll, dhe konfirmohen nga Pergjegjesi I Qendres.
4. Regjistrimi i përfituesit në regjistrin e qendrës.
5. Hapja e dosjes ne baze te legjislacionit ne fuqi per seciln perfitues.

V. Dokumentacioni

- Kërkesë me shkrim;
- Dokument identifikimi;
- Certifikatë familjare ose vërtetim banimi;
- Dokumente që vërtetojnë statusin social, kur është e aplikueshme.

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO



Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL
QENDRA SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE DEVOLL

Nr 69 Prot. **Bilisht më, 20.02.2026**

RELACION
Për Projekt-Vendimin
PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË PËRFITUESVE NË QENDRËN SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE TË BASHKISË DEVOLL VITI 2026

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenin 36 të Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", I ndyshuar, Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", I ndryshuar, ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojten e Fëmijëve", Ligji Nr. 86/2017 "Për financat e vetëqeverjes vendore", I ndryshuar, Ligji Nr.64/2025 "Për barazinë gjinore", Ligji nr. 11/2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, Ligji Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, VKM-së Nr. 224 datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimet të kujdesit shoqëror". Ligjin Nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar Vendimin nr.823, date 06.12.2006 "Per Standartet e Sherbimeve te Perkujdesit Shoqeror, per te Moshuarit ne Qendrat Ditore. VKM nr. 518/2018 për kriteret dhe procedurat e shërbimeve komunitare dhe rezidenciale për persona në nevojë. VKM nr. 425, datë 27.06.2019, për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.Udhezimit Nr.911, date 27.12.2018 ''Per miratimin e standarteve te sherbimeve te kujdesit shoqeror ne qendrat komunitare shumedisiplinore'' per te ofruar nje sherbim sa me cilesor per gruper vulnerable qe marin sherbim ne qender.

1. Nevoja për projekt–vendimin

Bashkia Devoll, në përmbushje të funksioneve të saj në fushën e shërbimeve sociale, ofron shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet Qendrës Shumëfunksionale Komunitare për kategori të ndryshme në nevojë, përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet në vështirësi ekonomike, gratë dhe fëmijët në situatë rreziku, si dhe individë të rrezikuar nga përjashtimi social.

Aktualisht, Qendra funksionon mbi bazën e një **Rregulloreje të brendshme të miratuar nga Këshilli Bashkiak**, e cila përcakton organizimin, funksionimin, llojet e shërbimeve, detyrat e stafit dhe rregullat e administrimit të saj. Megjithatë, për garantimin e një procesi të qartë, transparent dhe të barabartë pranimi për përfituesit e rinj gjatë vitit 2026, lind nevoja për

miratimin me vendim të posaçëm të **kritereve specifike të pranimit**, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kombëtare të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Ky projekt–vendim synon:

- të përcaktojë kriteret objektive të përzgjedhjes së përfituesve;
- të garantojë trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim;
- të sigurojë përputhshmëri me standardet shtetërore të ofrimit të shërbimeve;
- të rrisë transparencën dhe llogaridhënien institucionale.

2. Përfitimet sociale

Miratimi i këtij projekt–vendimi do të kontribuojë drejtpërdrejt në:

- garantimin e mbrojtjes sociale për kategoritë vulnerabël;
- përfshirjen dhe integrimin komunitar të individëve në nevojë;
- parandalimin e përjashtimit dhe marginalizimit social;
- rritjen e cilësisë dhe standardizimin e shërbimeve në nivel vendor;
- forcimin e mekanizmave të referimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Përmes vendosjes së kritereve të qarta, sigurohet që shërbimet të përfitojnë ata individë dhe familje që realisht ndodhen në kushte të vështira sociale dhe ekonomike, duke respektuar parimet e barazisë gjinore, mbrojtjes së fëmijëve dhe mosdiskriminimit.

3. Përputhshmëria me kuadrin ligjor

Projekt–vendimi është hartuar në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar në fushën e vetëqeverisjes vendore, mbrojtjes sociale, barazisë gjinore, mbrojtjes nga dhuna dhe diskriminimi, si dhe me aktet nënligjore që përcaktojnë standardet dhe metodologjinë e financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Ai respekton parimet e decentralizimit, subsidiaritetit dhe autonomisë vendore, duke i dhënë Bashkisë kompetencën për të përcaktuar dhe administruar shërbimet sociale sipas nevojave të komunitetit.

4. Efektet financiare

Zbatimi i këtij vendimi do të realizohet brenda fondeve të planifikuara në buxhetin vjetor të Bashkisë Devoll për vitin 2026 dhe në përputhje me metodologjinë e financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Projekt–vendimi nuk sjell kosto shtesë financiare për buxhetin vendor, por synon përdorim më efikas dhe të targetuar të burimeve ekzistuese.